



Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 23 korrik 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim i Pestë i Rishikimit të Paraburgimit

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Julius von Bone

Mbrojtëses së viktimave

Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykses) nxjerr vendimin e mëposhtëm të rishikimit të paraburgimit.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 nëntor 2020¹, 25 janar 2021,² dhe 25 mars 2021,³ përkatësisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake nxori “Vendimin për Rishikimin e Paraburgimit”, “Vendimin e Dytë të Rishikimit të Paraburgimit” dhe “Vendimin e Tretë të Rishikimit të Paraburgimit”, ku urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Salih Mustafës (“z. Mustafa ose i akuzuari”).
2. Më 25 maj 2021, Trupi Gjykses nxori “Vendimin e Katërt të Rishikimit të Paraburgimit” (“Rishikimi i Katërt i Paraburgimit”).⁴ Në Rishikimin e Katërt të Paraburgimit, Trupi Gjykses urdhëroi Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”), si edhe mbrojtësen e viktimave, nëse dëshironte, të paraqisnin parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit brenda të hënës, 5 korrik 2021, dhe Mbrojtjen, nëse dëshironte, të paraqiste parashtrimet e veta lidhur me sa më lart, brenda të hënës, 12 korrik 2021.⁵
3. Më 5 korrik 2021, ZPS-ja paraqiti parashtrimet e veta.⁶ Mbrojtësja e viktimave nuk paraqiti parashtrime.

¹ KSC-BC-2020-05, F00052, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit*, 23 nëntor 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00068, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i Dytë i Rishikimit të Paraburgimit*, 25 janar 2021, publik.

³ KSC-BC-2020-05, F00097, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i Tretë i Rishikimit të Paraburgimit* (“Rishikimi i Tretë i Paraburgimit”), 25 mars 2021, publik.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00127, Trupi Gjykses I, *Vendim i Katërt i Rishikimit të Paraburgimit*, 25 maj 2021, publik.

⁵ Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 29(b)-(c).

⁶ KSC-BC-2020-05, F00147, Prokurori i Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë lidhur me Rishikimin e Pestë të Paraburgimit* (“Parashtrimet e ZPS-së”), 5 korrik 2021, publik.

4. Më 11 korrik 2021, Mbrojtja paraqiti parashtrimet e veta.⁷

II. PARASHTRIMET

5. ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të të akuzuarit mbetet i domosdoshëm pasi nuk kanë ndryshuar rrethanat që do të ndryshonin konstatimin e Trupit Gjykues se ekziston gjasë mjaftueshmërisht reale se nëse lirohet, i akuzuari mund të ndërhyjë ndaj viktimave, dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre, dhe se asnjë kusht nuk do të zvogëlonte në masë të mjaftueshme këtë rrezik.⁸ Gjithashtu, rreziku i arratisjes dhe kryerjes së krimeve të tjera mbetet i lartë, dhe qysh prej rishikimit të fundit të paraburgimit, secili nga rreziqet e përmendura në nenin 41(6)(b) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) është rritur për shkak të afrimit të fillimit të gjykimit.⁹

6. Në lidhje me dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer krime brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara (“DHS”), ZPS-ja parashtron se që nga Rishikimi i Katërt të Paraburgimit, nuk ka ndryshuar asnjë nga rrethanat që mund të ndryshojnë këtë konstatim të bërë si nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ashtu edhe nga Trupi Gjykues.¹⁰ Në lidhje me rrezikun e arratisjes, ZPS-ja argumenton se ky rrezik mbetet i lartë, për arsyet e paraqitura në parashtrimet e saj lidhur me Rishikimin e Katërt të Paraburgimit.¹¹ Sa i takon rrezikut të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve dhe viktimave, ZPS-ja parashtron se ky rrezik jo vetëm që vazhdon të jetë i pranishëm por do të jetë dhe dukshëm më i madh, duke pasur parasysh afrimin e datës së fillimit të

⁷ KSC-BC-2020-05, F00151, Mbrojtja, *Parashtrim i Mbrojtjes lidhur me Rishikimin e Paraburgimit të të Akuzuarit* (“Parashtrimet e Mbrojtjes”), 11 korrik 2021, publik. Parashtrimi i protokolluar u njoftua më 12 korrik 2021.

⁸ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

⁹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 2.

¹⁰ Parashtrimet e ZPS-së, para. 3.

¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 3, i referohet KSC-BC-2020-05, F00122, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë lidhur me Rishikimin e Katërt të Paraburgimit* (“Parashtrimet e ZPS-së lidhur me Rishikimin e Katërt të Paraburgimit”), 17 maj 2021, publike.

gjykimit dhe heqjen e redaktimeve në materialet që janë objekt i masës mbrojtëse të shtyrjes së nxjerrjes së informacionit.¹² Lidhur me këtë, ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit të të akuzuarit mbetet thelbësor për zvogëlimin e këtij rreziku, në mënyrë që të kufizohen dhe monitorohen komunikimet e tij, masa të cilat nuk do të mund të zbatoheshin efektivisht në rast se ai do të lirohej përkohësisht ose me kusht.¹³ Në lidhje me rrezikun e kryerjes së krimeve të tjera, ZPS-ja u referohet parashtrimeve të mëparshme të saj dhe argumenton se edhe në këtë rast, rreziku jo vetëm që vazhdon të jetë i pranishëm por është dhe më i madh për shkak të afrimit të datës së fillimit të gjykimit dhe faktit se të akuzuarit do t'i nxirret më shumë informacion.¹⁴

7. ZPS-ja parashtron më tej se rreziqet që paraqet i akuzuari, të marra veçazi apo së bashku, mund të trajtohen efektivisht vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së, veçanërisht në këtë fazë të procesit kur do të hiqen redaktimet në materialet që janë objekt i masës mbrojtëse të shtyrjes së nxjerrjes së informacionit dhe do t'i zbulohen disa prej identiteteve të akuzuarit.¹⁵ Asnjë nga garancitë që mund të ofrojë i akuzuari nuk do të mjaftonte për garantimin e përmbushjes së kushteve të lirimit apo tejkalimin e rreziqeve konkrete të lirimit.¹⁶ Së fundi, ZPS-ja parashtron se gjykimi është caktuar të fillojë më 15 shtator 2021 dhe se që nga rishikimi i fundit i paraburgimit, procesi ka përparuar shpejt dhe në mënyrë efikase, pa periudha ndërprerjesh.¹⁷

8. Mbrojtja parashtron se z. Mustafa duhet të lirohet nga paraburgimi dhe se Trupi Gjykyes, nëse e vlerëson të domosdoshme, mund të caktojë çfarëdo kushtesh të lirimit që i gjykon të nevojshme dhe të përshtatshme.¹⁸ Për këtë qëllim, Mbrojtja parashtron se z. Mustafa nuk paraqet rrezik arratisjeje, duke mbajtur parasysht se ai: (i) ka jetën

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 5-6.

¹³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 7.

¹⁴ Parashtrime të ZPS-së, para. 8, duke iu referuar gjithashtu Parashtrimeve të ZPS-së lidhur me Rishikimin e Katërt të Paraburgimit, para. 11-12.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9-10.

¹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 10.

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 12.

¹⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 37.

shoqërore, ekonomike dhe familjare në Kosovë, (ii) nuk ka precedentë penalë; (iii) pothuajse nuk është larguar nga Kosova 20 vitet e fundit; (iv) nuk ka përbërë asnjëherë rrezik për askënd; (v) ka bashkëpunuar me ZPS-në kur i është kërkuar; dhe (vi) është i gatshëm të mbrohet në gjyq dhe për rrjedhojë nuk synon të arratiset asgjëkundi.¹⁹Mbrojtja më tej argumenton se faktorët e rrezikut të konstatuar në të shkuarën nuk mbështesin pretendimin për rrezikun e arratisjes së z. Mustafa.²⁰ Konkretisht, dijenia e z. Mustafa për akuzat dhe provat, teksa përparon çështja gjyqësore, nuk mund të konsiderohet si faktor rreziku kundër tij, pasi çdo i akuzuar duhet të vihet në dijeni për akuzat.²¹ Gjithashtu, zhvillimi i çështjes gjyqësore nuk varet nga i akuzuari, por përcaktohet nga gjykata.²² Vendimet e mëparshme të fajësisë kundër komandantëve të lartë të Zonës Operative të Llapit nuk mund të shërbejnë si motiv arratisjeje për z. Mustafa, pasi ai vetë nuk ka qenë asnjëherë komandant i lartë.²³ Po ashtu, lidhjet e pretenduara me aparatën e zbulimit në Kosovë dhe mundësia e tij për të udhëtuar në disa shtete pa vizë, edhe nëse supozohet se mund të konsiderohen si faktorë rreziku, mund të eliminohen me anë të caktimit të kushteve.²⁴

9. Mbrojtja më tej shton se i akuzuari nuk ka as synimin dhe as mjetet për të penguar procesin apo për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve dhe viktimave. Në veçanti, Mbrojtja argumenton se: (i) i akuzuari nuk ka asnjë motiv për pengimin e procesit pasi kjo do të ishte në dëm të tij; (ii) ideja se i akuzuari ka në dispozicion mjetet për pengimin e procesit, i ekzagjeron tej mase mjetet dhe aftësitë e tij; (iii) pretendimi se i akuzuari do të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve apo viktimave, apo se ekziston rrezik konkret se ai do të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve apo viktimave, është i pabazë; dhe (iv) asnjë prej rreziqeve të supozuara nuk është rritur me caktimin e datës së fillimit të gjykimit.²⁵

¹⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 5-13.

²⁰ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 14.

²¹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 15.

²² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 15.

²³ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 16.

²⁴ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 17-18.

²⁵ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19-27.

Mbrojtja po ashtu argumenton se “pengimi i procesit” është një frazë e mjegullt për të cilën as Trupi Gjykses dhe as ZPS-ja nuk kanë ofruar qartësim konkret.²⁶

10. Në lidhje me rrezikun se i akuzuari mund të kryejë krime, Mbrojtja parashtron se: (i) pas pothuajse një viti në paraburgim, ka ardhur koha që Trupi Gjykses të bëjë një konstatim konkret nëse z. Mustafa me të vërtetë do të përbente rrezik të kryerjes së krimeve, si edhe të saktësojë ato krime; (ii) supozimi se z. Mustafa - edhe pse nuk është paraburgosur në lidhje me asnjë akuzë 20 vitet e fundit - papritur do të fillonte të kryente krime, është i pabazë; dhe (iii) fakti se ka një datë të caktuar për fillimin e gjykimit nuk e ndryshon këtë në asnjë mënyrë.²⁷

11. Në këto rrethana, Mbrojtja parashtron se Trupi Gjykses duhet të vlerësojë nëse rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(i)-(ii) të Ligjit janë reale apo thjesht të supozuara, dhe se lidhur me rrezikun e përcaktuar në nenin 41(6)(b)(iii) të Ligjit, provat e paraqitura nga ZPS-ja nuk kanë qenë objekt i asnjë vlerësimi të vetëm.²⁸

12. Së fundi, Mbrojtja përsërit parashtrimet e mëparshme se mund të caktohen kushte të cilat i akuzuari do t'i respektojë, për të parandaluar çdo rrezik që mund të konstatojë Trupi Gjykses.²⁹

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

13. Trupi Gjykses merr parasysh nenet 29, 31(5), dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Kushtetuta”), nenet 3(2), 21(3), dhe 41(6), (10), dhe (12) të Ligjit dhe rregullën 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).

²⁶ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 19.

²⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 29-31.

²⁸ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 34-35.

²⁹ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 32, 36.

IV. ANALIZË

14. Në fillim, Trupi Gjykses rikujton se prezumimi i pafajësisë, i paraparë në nenin 31(5) të Kushtetutës, nenin 21(3) të Ligjit, dhe nenin 6(2) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është pikënisja për vlerësimin e vazhdimit të paraburgimit.³⁰ Për këtë arsye, vazhdimi i paraburgimit nuk mund të vendoset me lehtësi dhe i akuzuari duhet të lirohet në momentin që mbajtja e tij në paraburgim nuk është më e arsyeshme.³¹

A. DYSHIMI I BAZUAR

15. Sa i përket standardit lidhur me vazhdimin e paraburgimit, neni 41(6)(a) i Ligjit përcakton si parakusht³² ekzistencën e dyshimit të bazuar se është kryer një vepër penale që është nën juridiksionin e DHS-së.³³ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses thekson se me vetë vendimin e marrë nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për konfirmimin e aktakuzës kundër z. Mustafa,³⁴ kushti i nenit 41(6)(a) të Ligjit është përmbushur dhe konfirmuar nga një autoritet i pavarur gjyqësor pas analizës së provave të paraqitura prej ZPS-së.³⁵ Trupi Gjykses thekson se vlerësimi i provave mbi të cilat mbështeten akuzat do të kryhet gjatë gjykimit, kur do të përcaktohet fajësia apo pafajësia e z. Mustafa në bazë të provave përpara Trupit Gjykses.³⁶ Trupi Gjykses vlerëson se

³⁰ Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 13. *Shih edhe* KSC-BC-2020-06, IA004/F00005/RED, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimimin e Përkohshëm* (Vendimi mbi Apelin e Thaçit lidhur me Lirimimin e Përkohshëm), 30 prill 2021, para. 17.

³¹ Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 13; ECtHR/GJEDNJ, *Buzadji v. The Republic of Moldova*, no. 23755/07, [Judgment](#) [GC] (*Buzadji v. The Republic of Moldova* [GC]), 5 July 2016, para. 90.

³² Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 14; ECtHR/GJEDNJ, [Buzadji v. The Republic of Moldova](#) [GC], para. 87.

³³ Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 14 dhe poshtëshënimi 28.

³⁴ KSC-BC-2020-05, F00008/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës*, 5 tetor 2020, publik, para. 163(a).

³⁵ KSC-BC-2020-05, F00009/A01/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për z. Salih Mustafa*, 12 qershor 2020, publik, para. 1; F00009/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 12 qershor 2020, publik, para. 18.

³⁶ Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 14; Rishikimi i Tretë i Paraburgimit, para. 12.

përveç pretendimit të përgjithshëm se “gjykata duhet të shqyrtojë vlerën e qenësishme të provave në këtë çështje”,³⁷ Mbrojtja nuk paraqet asnjë argument konkret në mbështetje të pohimit të vet se dyshimi i bazuar kundër të akuzuarit nuk ekziston më. Po ashtu, Trupi Gjykses nuk identifikon asnjë arsye për të konstatuar se konfirmimi i aktakuzës kundër z. Mustafa ishte i papërshtatshëm apo i mangët, për aq sa i takon asaj se standardi i dyshimit të bazuar nuk përmbushet më.³⁸ Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se kushti i nenit 41(6)(a) të Ligjit vazhdon të përmbushet.

B. DOMOSDOSHMERIA E PARABURGIMIT

16. Trupi Gjykses rikujton standardin e zbatueshëm në lidhje me vlerësimin nëse vazhdimi i paraburgimit është i domosdoshëm, siç përcaktohet në Rishikimin e Katërt të Paraburgimit, si dhe rëndësinë e arsytimit specifik (në bazë të rrethanave të çështjes) dhe të arsyeve konkrete mbi të cilat duhet të mbështetet Trupi Gjykses në marrjen e vendimit, siç ka theksuar Paneli i Gjykatës së Apelit.³⁹

17. Në veçanti, për sa i përket dispozitës 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Trupi Gjykses rikujton se, sikurse në lidhje me të gjitha rreziqet e tjera të përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit, ajo që duhet të kryejë Trupi Gjykses është vlerësimi i rrezikut.⁴⁰ Në këtë kontekst, për të vlerësuar nëse rreziku i pengimit mund të jetë i pranishëm në të ardhmen, nuk ka nevojë të vërtetohet se realisht ka pasur pengim në të shkuarën.⁴¹

³⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 28.

³⁸ *Ngjashëm*, Rishikimi i Katërt të Paraburgimit, para. 14.

³⁹ Rishikimi i Katërt të Paraburgimit, para. 15-17, i referohet edhe Vendimit mbi Apelin e Thaçit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, para. 22.

⁴⁰ Rishikimi i Katërt të Paraburgimit, para. 17.

⁴¹ *Ngjashëm*, KSC-BC-2020-06, IA001/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit Kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 38.

1. Rreziku i arratisjes

18. Në lidhje me rrezikun e arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Trupi Gjykses rikujton vlerësimin e vet në Rishikimin e Katërt të Paraburgimit⁴² dhe gjykon se faktorët mbi të cilët është bazuar ZPS-ja ende nuk tregojnë (mjaftueshëm) se z. Mustafa përbën rrezik arratisjeje. Në veçanti, Trupi Gjykses nuk mendon se dijenia e të akuzuarit për akuzat, mundësia e një dënimi me burgim të gjatë nëse shpallet fajtor, dijenia për vendime të mëparshme fajësie kundër anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga e njëjta zonë operative, dhe lidhjet e tij me aparatin e zbulimit në Kosovë, mund t'i krijojnë z. Mustafa motivin për t'u arratisur. Në lidhje me mundësinë e tij për të udhëtuar pa vizë në disa shtete, Trupi Gjykses nuk e konsideron këtë faktor mjaftueshmërisht të fortë për përcaktimin e rrezikut të arratisjes. Kur vlerëson rrezikun e arratisjes, Trupi Gjykses fillimisht merr parasysh bashkëpunimin që ka shfaqur z. Mustafa kundrejt ZPS-së para konfirmimit të aktakuzës. Trupi Gjykses më tej merr parasysh se z. Mustafa ka vendbanimin e përhershëm në Kosovë dhe marrëdhënie familjare të qëndrueshme, si edhe lidhje ekonomike dhe shoqërore me vendlindjen e tij. ZPS-ja nuk ka demonstruar fakte apo rrethana që do ta çonin Trupin Gjykses drejt një përfundimi të ndryshëm. Për rrjedhojë, Trupi Gjykses vlerëson se që prej Rishikimit të Katërt të Paraburgimit në të cilin Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa nuk përbën rrezik arratisjeje,⁴³ nuk ka pasur ndonjë informacion apo zhvillim të ri që vë në dyshim konstatimet e mësipërme.

19. Rrjedhimisht dhe siç ka konstatuar në Rishikimin e Katërt të Paraburgimit, Trupi gjykses vlerëson se z. Mustafa nuk përbën rrezik arratisjeje dhe se një rrezik i tillë, edhe në rast se është i pranishëm, mund të zvogëlohet në masë të

⁴² Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 18.

⁴³ Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 18.

mjaftueshme me anë të kushteve që i caktohen të akuzuarit në bazë të nenit 41(12) të Ligjit dhe rregullës 56(5) të Rregullores.

2. Rreziku i pengimit të ecurisë së proceseve të DHS-së

20. Në lidhje me rrezikun e përcaktuar në nenin 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Trupi Gjykses fillimisht vëren se rreziku i pengimit "të ecurisë së procedimit penal përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit" i referohet para së gjithash rrezikut të pengimit të procesit objekt i të cilit është një i akuzuar, duke qenë se pikërisht në lidhje me një proces të tillë një person i akuzuar do të kishte motivin dhe mjetet - që do të thotë dijeninë e nevojshme se kush janë dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit përkatës - për të ndërhyrë ndaj tyre.

21. Sa i takon ekzistencës së këtij rreziku në lidhje me z. Mustafa, Trupi Gjykses vlerëson se shumica e faktorëve të rrezikut të renditur më lart në kontekst të rrezikut të arratisjes në të vërtetë janë të rëndësishëm në kontekst të këtij rreziku. Në veçanti, Trupi Gjykses është i mendimit se dijenia e të akuzuarit për akuzat dhe për mundësinë e një dënimi me burgim të gjatë nëse shpallet fajtor, mund t'i shërbejnë si motiv për të ndërhyrë ndaj viktimave dhe dëshmitarëve dhe/ose familjeve të tyre, nëse lirohet. Duke mbajtur parasysh lidhjet e z. Mustafa me aparatën e zbulimit në Kosovë dhe përvojën e tij në këtë drejtim, një ndërhyrje e tillë mund të realizohet, ndër të tjera përmes: (i) ushtrimit të trysnisë, duke përfshirë përmes dhunës dhe kërcënimeve, ose orvatjeve për të ushtruar ndikim mbi viktimat dhe dëshmitarët, dhe/ose familjet e tyre; (ii) frikësimit të viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes të tjerëve; dhe/ose (iii) bashkëpunimit me kryes të tjerë të mundshëm të përmendur në aktakuzën e konfirmuar, apo me këdo tjetër të përfshirë në këtë çështje ose çështje të tjera gjyqësore. Kjo vlen aq më shumë në këtë fazë të procesit, kur - duke mbajtur parasysh afrimin e datës së fillimit të gjykimit dhe të dhënies

së dëshmisë prej dy dëshmitarëve të parë të ZPS-së⁴⁴ - nxjerrja e pritshme e informacionit të mëtejshëm për të akuzuarin, dhe veçanërisht e identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur të ZPS-së, do ta bënte më të lehtë për të akuzuarin si oficer zbulimi me përvojë dhe që ka njohuritë teknike dhe rrjetin e nevojshëm, të mund të ndërhyjë ndaj viktimave dhe dëshmitarëve dhe/ose familjeve e tyre, dhe në përgjithësi të pengojë ecurinë e procesit. Gjithashtu, kuadri i kufizuar i kësaj çështjeje gjyqësore dhe numri i kufizuar i dëshmitarëve mund të zmadhojnë rrezikun e ndërhyrjes ndaj këtyre viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre. Sikurse theksohet më lart,⁴⁵ mungesa e provave se në të shkuarën i akuzuari është orvatur të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve apo viktimave, ose të pengojë ecurinë e procesit në përgjithësi, nuk është vendimtare për vlerësimin e Trupit Gjyqësor sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, sepse ajo që Trupi Gjyqësor duhet të bëjë në këtë drejtim është një vlerësim rreziku. Në përputhje me sa më lart, Trupi Gjyqësor konstaton se që prej Rishikimit të Katërt të Paraburgimit, nuk ka pasur ndonjë informacion apo zhvillim të ri që vë në dyshim konstatimet e mësipërme.

22. Rrjedhimisht, Trupi Gjyqësor konstaton se ekziston gjasë mjaftueshmërisht reale se z. Mustafa mund të pengojë ecurinë e proceseve të DHS-së përmes ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

23. Trupi Gjyqësor rikujton se, meqë kushtet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit janë si alternativë e njëri-tjetrit, me përmbushjen e një prej këtyre kushteve, nuk është e nevojshme të shqyrtohen kushtet e tjera për vazhdimin e masës së paraburgimit.⁴⁶

⁴⁴ KSC-BC-2020-05, F00138, Trupi Gjyqësor I, *Vendim mbi Datën e Fillimit të Gjyqimit dhe Pika të Tjera që lidhen me Të* (Vendimi mbi Fillimin e Gjyqimit), 18 qershor 2021, publik, para. 22(f), (i).

⁴⁵ *Shih më lart* para. 17.

⁴⁶ Vendim mbi Apelin e Thaçit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, para. 78.

24. Pasi ka konstatuar se ekziston mundësi mjaftueshmërisht reale se z. Mustafa do të pengojë proceset e DHS-së, ndër të tjera përmes ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre,⁴⁷ Trupi Gjykses konstaton se nuk ka nevojë të shqyrtojë rrezikun e përcaktuar në nenin 41(6)(b)(iii) të Ligjit.⁴⁸

4. Përfundim

25. Duke mbajtur parasysh vlerësimet e mësipërme, Trupi Gjykses konstaton se ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se rreziku i pengimit të proceseve të DHS-së, përcaktuar në nenin 41(6)(b)(ii) të Ligjit, vazhdon të jetë i pranishëm.

C. LIRIMI ME KUSHT

26. Trupi Gjykses rikujton se masa e paraburgimit duhet të vazhdohet vetëm nëse nuk ka më masa më të buta që mund të zvogëlojnë mjaftueshëm rreziqet e përcaktuara në nenin 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.⁴⁹ Në këtë kontekst, Trupi Gjykses ka detyrimin të shqyrtojë dhe të vlerësojë, *proprio motu*, të gjitha kushtet e arsyeshme që mund t'i caktohen një të akuzuari, dhe jo vetëm ato që parashtron Mbrojtja.⁵⁰

27. Sa i takon rrezikut të pengimit të ecurisë së proceseve të DHS-së, në bazë të faktorëve të rrezikut të renditur më lart,⁵¹ Trupi Gjykses vlerëson se asnjë kusht nuk mund të kufizojë sa duhet aftësinë e z. Mustafa për të pasur qasje në informacion dhe burime që do të lehtësonin orvatjet për pengimin e proceseve të DHS-së përmes ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre. Po ashtu, asnjë

⁴⁷ *Shih më lart*, para. 20-22.

⁴⁸ *Ngjashëm*, Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 22.

⁴⁹ Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 24; KSC-CC-2020-09, F00006, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktoendim mbi Referimin e Ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provatave të Miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020*, 22 maj 2020, publik, para. 70.

⁵⁰ Rishikimi i Katërt i Paraburgimit, para. 24. *Shih edhe* KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm*, 30 prill 2021, publik, para. 86.

⁵¹ *Shih më lart*, para 20-22.

kusht nuk mund të sigurojë kufizimin ose monitorimin e duhur të komunikimeve private ose lëvizjeve të z. Mustafa, që mund të përdoren për të kërkuar ose marrë informacion dhe burime që lehtësojnë ndërhyrjen ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre; dhe asnjë prej këtyre kushteve nuk mund të zbatohet siç duhet dhe as të monitorohet mjaftueshëm. Trupi Gjykses vlerëson se komunikimet dhe aktivitetet e z. Mustafa mund të kufizohen dhe monitorohen me efektshmëri vetëm përmes kornizës së monitorimit të komunikimeve të zbatueshme në objektin e paraburgimit të DHS-së, me çka zvogëlohet rreziku që ai të pengojë proceset e DHS-së.

28. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se asnjë kusht, përfshirë ato të propozuara më parë nga Mbrojtja,⁵² si edhe asnjë kufizim shtesë që mund të vendosë Trupi Gjykses, nuk do të zvogëlonin në masë të mjaftueshme rrezikun e pengimit të proceseve të DHS-së. Për këtë arsye, z. Mustafa duhet të mbetet në paraburgim.

D. ARSYESHMËRIA E KOHËZGJATJES SË PARABURGIMIT

29. Trupi Gjykses vëren se z. Mustafa ndodhet në paraburgim për dhjetë muaj, që prej arrestimit dhe transferimit të tij në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, Holandë, më 24 shtator 2020. Trupi Gjykses mban parasysh se z. Mustafa akuzohet për krime të rënda lufte sipas nenit 14 të Ligjit, përfshirë për vrasje dhe torturë, që pretendohet se janë kryer sipas më shumë formave të përgjegjësisë penale në bazë të nenit 16 të Ligjit. Trupi Gjykses nuk ka identifikuar asnjë periudhë ndërprerjesh në procesin kundër të akuzuarit para DHS-së, që do të çonte në një përfundim se kohëzgjatja e paraburgimit është e paarsyeshme. Gjithashtu, Trupi Gjykses merr parasysh se: (i) gjykimi do të fillojë të mërkurën,

⁵² Parashtrimet e Mbrojtjes, para. 36.

më 15 shtator 2021, sipas procedurës së përcaktuar në rregullën 124 dhe 125 të Rregullores, vijuar prej deklaratave hyrëse të ZPS-së dhe mbrojtëses së viktimave; dhe (ii) dy dëshmitarët e parë të ZPS-së do të dëshmojnë midis të hënës, 20 shtator 2021, dhe të martës, 28 shtator 2021.⁵³ Mbi të gjitha, Trupi Gjykses vëren se palët synojnë të thërrasin një numër të kufizuar dëshmitarësh.

30. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk gjykon se z. Mustafa mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes në bazë të rregullës 56(2) të Rregullores.

V. VENDIM

31. Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykses:

- a. **URDHËRON** vazhdimin e paraburgimit të z. Mustafa;
- b. **URDHËRON** ZPS-në dhe mbrojtësen e viktimave, nëse dëshiron, të paraqesin parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit brenda të hënës, 6 shtator 2021; dhe
- c. **URDHËRON** Mbrojtjen të paraqesë parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit brenda të hënës, 13 shtator 2021.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

⁵³ Vendimi mbi Fillimin e Gjykimit, para. 22(f), (i).

/nënshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E premte, 23 korrik 2021

Në Hagë, Holandë.